

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 4233/Prot
11

Pogradec, më 22.09.2022

VENDIM

NR. 103, DATË 22.09.2022

“PËR MIRATIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES SË ANËTARËVE TË KËSHILLIT VENDOR TË RINISË, SI DHE TË MËNYRËS SË ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË TIJ NË BASHKINË POGRADEC”

Këshill Bashkiak Pogradec, në mbledhjen e tij të datës 20.09.2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ligjit nr. 75/2019, “Për rrinë”; të nenit 21, 24, 25, 30, 54, i ndryshuar;

VENDOSI:

1. Miratimin e kriterëve dhe procedurave të zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë (në vijim KVR), si dhe të mënyrës së organizimit e të funksionimit të tij, sipas Shtojcës bashkëngjitur dhe pjesë integrale e këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Turizmit, Trashëgimisë Kulturore dhe Rinisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit.

KRYETARI KËSHILLIT

Sotiraq MANGERI



Qëllimi dhe funksioni i Këshillit Vendor Rinor

1. Këshilli Vendor i Rinisë është organ këshillimor, që funksionon pranë Kryetarit të Bashkisë. Këshilli Vendor i Rinisë ushtron kompetencat e mëposhtme:

- a) këshillon njësitë e vetëqeverisjes vendore për drejtimin e politikave dhe planeve vendore për rininë;
- b) vlerëson situatën e të rinjve dhe zbatimin e planeve dhe politikave rinore në nivel vendor;
- c) propozon përmirësime të politikave vendore rinore, si dhe nismat që i përshtaten nevojave të të rinjve në territorin ku veprojnë;
- d) bashkëpunon dhe shkëmben informacion me Këshillin Kombëtar të Rinisë.

2. Këshilli Vendor i Rinisë kryesohet nga Kryetari i Bashkisë dhe përbëhet nga të paktën 4 deri në 6 anëtarë. Anëtarët e Këshillit Vendor të Rinisë emërohen me urdhër të Kryetarit të Bashkisë.

3. Kriteret, procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë, si dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Vendor të Rinisë miratohen me vendim të Këshillit Bashkiak, duke iu referuar, për aq sa është mundur, kriterëve dhe procedurave të miratuara nga Këshilli i Ministrave për Këshillin Kombëtar të Rinisë.




A. Kriteret dhe procedurat të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor Rinor në Bashkinë Pogradec:

1. KVR-ja përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, ku respektohet parimi i barazisë gjinore. Përbërja e KVR-së vijon si më poshtë:
 - a. Kryetari i Bashkisë (kryeson);
 - b. Përfaqësues nga Sektori i rinisë, Qendra Rinore apo Këshilli Bashkiak;
 - c. (5) përfaqësues nga të rinj aktivë dhe nga organizatat rinore dhe /ose për të rinjtë të qytetit të Pogradecit dhe Njësive Administrative;
2. Anëtarët e KVR-së emërohen me urdhër të Kryetarit të Bashkisë dhe mandati i tyre është dy vjeçar, me të drejtë riemërimi.
3. Anëtari i KVR-së mund të japë dorëheqjen në çdo kohë, duke njoftuar me shkrim kryetarin. Anëtari i dorëhequr është i detyruar të përmbushë të gjitha detyrimet e lëna deri në miratimin e urdhrit të ndryshimit.
4. Anëtarët e KVR-së duhet të deklarojnë çdo rast të konfliktit të mundshëm të interesit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
5. Anëtarët e KVR-së kryejnë detyrën e tyre bazuar në parimin e mos-diskriminimit, të meritës, transparencës dhe gjithë-përfshirjes.

Procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor Rinor të Bashkisë Pogradec.

6. Kandidatët për anëtar të KVR-së identifikohen dhe shprehin interesin në bazë të një thirrje për të marrë pjesë në KVR, të njoftuar nga Kryetari, në faqen zyrtare të institucionit, në mjediset e bashkisë dhe/ose në rrjetet sociale të institucionit.
7. Përzgjedhja mes individëve që kanë shprehur interes nga Këshilli Bashkiak dhe/ose administrata bëhet nga Kryetari duke u bazuar në kriterin e përvojës së mëparshme me organizatat jofitimprurëse dhe në projekte që lidhen me të rinjtë.
8. Përzgjedhja mes kandidatëve përfaqësues të organizatave rinore ose për të rinjtë, bëhet nga kryetari dhe komisioni vlerësues dhe bazohet në kriteret e mëposhtme:
 - a) të jetë anëtar i një organizate rinore ose për të rinjtë;
 - b) të mos jetë i dënuar;
 - c) të ketë përvojë në projekte, nisma dhe veprimtari rinore dhe për të rinjtë;
 - d) të mos ketë konflikt interesi për shkak të angazhimit të KVR;



9. Kandidati për anëtar të KVR-së, përfaqësues i organizatave rinore, duhet të plotësojë këto kritere:
- të ketë dhënë kontribut në fushën e rinisë të paktën për 2 (dy) vitet e fundit, nëpërmjet projekteve me fokus rinor apo të zhvillimit të nismave ose të aktiviteteve për promovimin e të rinjve;
 - të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
 - të mos ketë konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjore.
10. Kandidati për anëtar të KVR-së, jo përfaqësues i organizatave rinore, duhet të plotësojë këto kritere:
- të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
 - të ketë përvojë pune në fushën e zhvillimit apo të zbatimit të aktiviteteve rinore, apo të ketë qenë pjesë e nismave ose aktiviteteve për promovimin e të rinjve;
 - të mos ketë konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe të dispozitave ligjore në fuqi.
11. Kandidati, për t'u emëruar anëtar i KVR-së, duhet të paraqesë, përkatësisht, dokumentacionin si vijon:
- Kandidati, të rinj aktiv dhe përfaqësues të organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë:
 - kërkesën;
 - jetëshkrimin (CV: fotokopje të dokumenteve që vërtetojnë jetëshkrimin);
 - letër referencë për angazhim në aktivitete/projekte me fokus rinor
 - vërtetimin e gjendjes gjyqësore ose vetëdeklarimin e saj;
 - vetëdeklarimin e konfliktit të interesit.
 - CV e organizatës që përfaqëson
 - letër motivimi;
 - kandidati, jo përfaqësues i organizatave rinore:
 - kërkesën;
 - jetëshkrimin (CV: fotokopje të dokumenteve që vërtetojnë jetëshkrimin);
 - vërtetimin e gjendjes gjyqësore ose vetëdeklarimin e saj;
 - letër motivimi;
 - vetë-deklarimin e konfliktit të interesit




12. Thirrja për aplikim për kandidaturat e përmendura në shkronjat “e”, “f” dhe “g”, të pikës 2, të këtij vendimi, publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Pogradec www.bashkiapogradec.gov.al për një periudhë prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh.
13. Shqyrtimi i aplikimeve dhe përzgjedhje e tyre bëhet brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga data e mbylljes së aplikimeve.
14. Rezultati i përzgjedhjes do shpallet nga Kryetari i Bashkisë dhe publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Pogradec: www.bashkiapogradec.gov.al për një periudhë prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh.

C. Organizimi dhe funksionimi i Këshillit Vendor Rinor

15. Këshilli Vendor Rinor është organ këshillimor, që funksionon pranë Kryetarit të Bashkisë. KVR-ja ushtron kompetencat e mëposhtme, sipas Ligji 75/2019 “Për Rininë”, neni 10, pika 1:
 - a. këshillon njësitë e vetëqeverisjes vendore për drejtimin e politikave dhe planeve vendore për rininë;
 - b. vlerëson situatën e të rinjve dhe zbatimin e planeve dhe politikave rinore në nivel vendor;
 - c. propozon përmirësime të politikave vendore rinore, si dhe nismat që i përshtaten nevojave të të rinjve në territorin ku veprojnë;
 - d. bashkëpunon dhe shkëmben informacion me Këshillin Kombëtar të Rinisë.
16. KVR-ja mbledhet jo më pak se 4 (herë) herë në vit.
17. Mbledhja e KVR-së zhvillohet kur janë të pranishëm të paktën gjysma (1/2) e anëtarëve të saj.
18. Veprimtaria e KVR mbështetet nga Sekretariatit teknik i cili përbëhet nga (1) një ose më shumë punonjës të Bashkisë të ngarkuar nga Kryetari me këtë detyrë.
19. Sekretariati teknik organizon mbledhjet në bazë të nevojave që shprehen nga rradhët e kryetarit ose të anëtarëve.



20. Sekretariati teknik njofton anëtarët e KVR-së, të paktën 7 (shtatë) ditë përpara datës së përcaktuar për mbledhjen (data, ora, vendi) me anë të e-mail: gendrarinorepogradec@gmail.com
21. Sekretariati teknik mban proces verbalin dhe çdo komunikim tjetër që lidhet me veprimtarinë e KVR-së. Procesverbali nënshkruhet nga çdo pjesëmarrës prezent në mbledhjen e KVR-së.
22. Mbledhjet e KVR zhvillohen kur janë të pranishëm të paktën 3 anëtarë. Nëse nuk paraqiten në mbledhje numri minimal i anëtarëve pjesëmarrës, takimi shtyhet për një datë të mëvonshme.
23. Mandati i anëtarit të KVR-së mbaron kur:
 - a. përfundon afati dyvjeçar nga data e emërimit;
 - b. humbet zotësinë juridike për të vepruar me vendim gjykatë apo dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë;
 - c. jep dorëheqjen.
24. Anëtari i Këshillit Vendor të Rinisë lirohet nga detyra, para mandatit, nga kryesuesi i KVR me më shumë së $\frac{1}{2}$ e votave, në rastet kur:
 - a. nuk paraqitet, pa shkaqe të justifikuara, në të paktën 3 (tri) mbledhje të njëpasnjëshme të KVR-së;
 - b. paraqiten shkaqe objektive, që e bëjnë të paaftë për të kryer funksionet e ngarkuara;
 - c. nuk përmbush detyrimet si anëtar i KVR-së;
 - d. veprimet apo mosveprimet e tij kanë dëmtuar rëndë veprimtarinë dhe emrin e KVR-së.
25. Anëtari i KVR-së, të cilit i është ndërprerë mandati apo është liruar nga detyra, zëvendësohet nga kryesuesi dhe sekretariati teknik me një kandidat që përmbush kriteret e përcaktuara në këtë vendim, i cili ka qenë i kandiduar.
26. Kohëzgjatja e mandatit të anëtarit zëvendësues është sa pjesa e mbetur e mandatit të anëtarit të larguar.
27. Anëtari pajiset me referencë të lëshuar nga Kryetari i Bashkisë për kontributin e dhënë në sektorin e rinisë.



D. Detyrat dhe detyrimet e Këshillit Vendor Rinor

28. Promovon projektet dhe iniciativat për të rinjtë iniciuar nga Bashkia Pogradec dhe nga organizatat e shoqërisë civile;
29. Këshillon njësitë e vetëqeverisjes vendore për drejtimin e politikave dhe planeve vendore për rininë;
30. Vlerëson situatën e të rinjve dhe zbatimin e planeve dhe politikave rinore në nivel vendor;
31. Nxitë takime, diskutime me të rinjtë në gjithë territorin e Bashkisë Pogradec.
32. Propozon përmirësime të politikave vendore rinore, si dhe nismat që i përshtaten nevojave të të rinjve në territorin ku veprojnë;
33. Merrë pjesë në trajnimet e propozuara nga aktorët publik dhe jopublik për ngritjen e kapaciteteve.

Ngarkohet Kryetari i Bashkisë për zbatimin e këtij vendimi.

